



SHOQATA KOMBETARE E TRANSPORTIT QYTETAS

Datë, 21.08.2026

KËRKESË

Kërkues: Shoqata Kombëtare e Transportit Qytetas, me nipt K42407012T, me adresë Rruga "Llazi Miho" Nd. 6, Sh. 1, Kat 1, Kombinat, Tiranë.
Të dhënat elektronike të kontaktit (neni 154/2/a i KPC) Tel: **068 4030111**

LËNDA: Mbi situatën e vështirë të transportit publik dhe nevojën për vijimin e kompensimit të kostos së karburantit.

DREJTUAR: KRYEMINISTRISË

Ministër i Shtetit për Pushtetin Vendor

Z.Ervin DEMO

BASHKISË TIRANË

Kryetar

Zj.Anuela RISTANI

Drejtor i Përgjithshëm i Punëve Publike

Z.Enton PUNAVIJA

MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Z.Enea KARAKACI

MINSITRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË

Z.Petrit MALAJ

MINSITRISË SË EKONOMISË DHE INOVACIONIT

Zj,Delina IBRAHIMAJ



SHOQATA KOMBETARE E TRANSPORTIT QYTETAS

Të nderuar,

Shoqata e Transportit Publik Qytetas, në përfaqësim të operatorëve që ushtrojnë aktivitetin në shërbimin e transportit publik qytetas, dëshiron të sjellë në vëmendjen tuaj situatën e vështirë ekonomike dhe operacionale me të cilën po përballen aktualisht shoqëritë e transportit publik, si pasojë e vazhdimit të nivelit të lartë të çmimit të karburantit. Karburanti përbën një nga zërat kryesorë dhe më të rëndësishëm të kostos së aktivitetit të transportit publik. Për shkak të volumit të lartë të konsumit ditor të mjeteve, çdo rritje apo qëndrueshmëri e çmimit të naftës në nivele të larta reflektohet drejtpërdrejt në kostot e operimit të operatorëve. Në kushtet kur tarifat e transportit publik mbeten të pandryshuara dhe operatorët duhet të garantojnë vijimësinë e shërbimit sipas linjave, frekuencave dhe kapaciteteve të përcaktuara, përballimi i kësaj kostoje është bërë gjithnjë e më i vështirë.

Masat e kompensimit të ndërmarra deri më tani kanë qenë një mbështetje e domosdoshme për ruajtjen e ekuilibrit financiar dhe vijimësinë e shërbimit. Megjithatë, problematika që solli nevojën për këtë mbështetje nuk është tejkaluar. Çmimi i karburantit vazhdon të mbetet në nivele të larta dhe të ushtrojë presion të konsiderueshëm mbi kostot operative të shoqërive. Nëse kjo situatë vijon edhe gjatë muajit Gusht 2026 dhe muajve në vijim, pa u shoqëruar me një mekanizëm kompensimi financiar, operatorët do të përballen me vështirësi serioze për garantimin e shërbimit në nivelin aktual. Pamundësia për të përballuar në mënyrë të vazhdueshme kostot e karburantit dhe shpenzimet e tjera operative mund të sjellë pasoja të drejtpërdrejta, ndër të cilat:

- vështirësi në garantimin e vazhdimësisë normale të shërbimit të transportit publik;
- reduktim të numrit të mjeteve të vendosura në qarkullim;
- ulje të frekuencës së mjeteve në linjat përkatëse dhe rritje të intervaleve të pritjes për qytetarët;
- vështirësi në përmbushjen e detyrimeve financiare dhe operative të shoqërive;
- shtyrje të investimeve dhe të ndërhyrjeve të nevojshme për mirëmbajtjen e flotës;
- rrezik për përkeqësimin e cilësisë dhe standardeve të shërbimit të ofruar ndaj qytetarëve.

Duhet të theksojmë se transporti publik qytetas është një shërbim me interes të drejtpërdrejtë publik, i cili duhet të funksionojë me vazhdimësi, regularitet dhe kapacitet të mjaftueshëm, pavarësisht luhatjeve të kostove të tregut. Për këtë arsye, një përkeqësim i qëndrueshmërisë financiare të operatorëve nuk prek vetëm shoqëritë që ofrojnë shërbimin, por reflektohet drejtpërdrejt te mijëra qytetarë që përdorin çdo ditë transportin publik.

Në këto kushte, Shoqata e Transportit Publik Qytetas kërkon që të shqyrtohet me prioritet vijimi i skemës së kompensimit për karburantin edhe për muajin shtator 2026, si dhe për muajt në vijim, për aq kohë sa çmimi i karburantit dhe kushtet ekonomike që kanë justifikuar këtë mbështetje vazhdojnë të mbeten në nivele të larta. Vlerësojmë se vijimi i kompensimit është një masë e domosdoshme për të ruajtur kapacitetet aktuale të transportit publik, për të shmangur reduktimin e mjeteve dhe të frekuencave, si dhe për të garantuar që barra e kostove të jashtëzakonshme të karburantit të mos ndikojë negativisht në cilësinë dhe vazhdimësinë e shërbimit ndaj qytetarëve.



SHOQATA KOMBETARE E TRANSPORTIT QYTETAS

Kërkojmë angazhimin dhe ndërhyrjen tuaj institucionale për miratimin e vijimit të kompensimit financiar për muajin Qershor-Korrik-Gusht 2026 dhe për periudhën pasuese, deri në normalizimin e çmimit të karburantit dhe të kushteve ekonomike të ushtrimit të aktivitetit.

Shoqata dhe operatorët që ajo përfaqëson mbeten të gatshëm për të vënë në dispozicion të institucioneve përgjegjëse çdo të dhënë ekonomike, financiare apo operative të nevojshme për të evidentuar ndikimin real që çmimi aktual i karburantit ka mbi funksionimin e shërbimit të transportit publik.

Me respekt,

Shoqata Kombëtare e Transportit Qytetas

KRYETAR

Kostandin Foni

Kostandin Foni

